



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 2456 Prot.

Tiranë, më 20.09/2024

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 16, datë 20.09.2024

“PËR

ZBATIMIN E URDHËRIT TË PËRBASHKËT NR.112. DATË 10.07.2024
TË QSHA DHE QNRRASH
PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
RREGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK
2024-2025, RAUNDI I DYTË”

Mbështetur në Urdhërin e Përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, Nr.112, datë 10.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2023-2024”, në Udhëzimin Nr.12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe në Rregulloret e Brendshme të Fakulteteve “Për zhvillimin e konkursit të pranimit për vitin akademik 2024-2025, Rektori

URDHËRON:

1. Datat e regjistrimit të kandidatëve për konkursin e pranimit janë **22 shtator deri në orën 11:00 të datës 24 shtator për Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe 22 shtator deri në orën 11:00 të datës 25 shtator për Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit.**
2. Dokumentet që duhet të ketë kandidati për regjistrim për konkurset e pranimit do të jenë:
 - 2 fotografi dokumenti 4x6
 - Fotokopje e kartës së identitetit
 - Mandat pagesa e tarifës së konkurimit
 - Kartela mjekësore
3. Konkursi i pranimit për FSHL-në do të zhvillohet ne date **24.09.2024** dhe për FVFR në **daten 25.09.2024**, data të cilat janë afishuar në faqen zyrtare të UST-së.
4. Fakultetet të marrin masat për sigurimin e bazës materiale të domosdoshme për zhvillimin e konkursit të pranimit. Gjatë ditëve të konkursit duhet të jetë i pranishëm një nga mjekët e secilit fakultet bashkë me materialet e nevojshme për dhënien e ndihmës së shpejtë.

5. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Sektori i Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes), të komunikojnë me subjektet përkatëse për të siguruar mosndërprerjen e energjisë elektrike ne datat 24.09.2024 dhe 25.09.2024. Për një mbarëvajtje sa më të mirë dhe cilësore, të sigurohet gjithashtu brenda të njëjtave data edhe shërbimi i përforcuar nga Komisionariati i Policisë për mbikqyrjen e konkursit të pranimit.
6. Grafiku i daljes në punë në zbatim të këtij Urdhëri do të jetë si vijon:

DATA	Denada Ahmeti	Majlinda Rëmbeci	Pranvera Lozi	Mimoza Reçi	Laura Kokomani	Enerajda Xhindole
22.09.2024	*	*		*		*
28.09.2024		*	*	*	*	
29.09.2024		*	*	*	*	
05.10.2024		*	*	*	*	
06.10.2024		*	*	*	*	

7. Orari zyrtar për zbatimin e këtyre procedurave do të jetë nga ora 08:00 deri 15:30. Ditët e paflektuara në grafik, janë ditë normale të punës. Për të gjithë punonjësit që për shkak të këtij Urdhëri janë të detyruar të dalin në punë ditët e pushimeve (të shtuna, të diela dhe ditë pushimi zyrtare), likujdimi i detyrimit nga ana e Institucionit do të kryhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.
8. Ngarkohen Dekanatet e Fakulteteve, Administratori i UST-së, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Sektori i Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes), Drejtoria e Marrdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit; të marrin masa për plotësimin e të gjitha detyrimeve dhe zbatimin e këtij Urdhëri.
9. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof.Dr. Agron KASA

